



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 6 mars 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Haxhi Shalës për Rishikim (F00685) dhe

Klasifikimin e Parashtrimeve

T'i njoftohet:

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris

Zyrës Administrative
Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses) lëshon këtë Vendim mbi Kërkesën e Haxhi Shalës për Rishikim (F00685) dhe Klasifikim të Parashtrimeve.

I. HISTORIKU ROCEDURAL

1. Më 13 shkurt 2025, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi Kërkesën për Rishikimin e Vendimit të Administratores për Honoraret e Ndihmës Juridike (F00518)" (Vendimi i Kundërshtuar).¹
2. Më 18 shkurt 2025, në zbatim të Vendimit të Kundërshtuar, Administratorja dorëzoi parashtrime në lidhje me klasifikimin e parashtrimit F00518.²
3. Më 19 shkurt 2025, mbrojtësi i z. Haxhi Shala (përkatësisht, mbrojtësi dhe z. Shala) dorëzoi kërkesë për rishikimin e Vendimit të Kundërshtuar (Kërkesa).³ Po atë ditë, mbrojtësi dorëzoi parashtrime të veçanta mbi klasifikimin e parashtrimeve F00518 dhe F00563 që kishin të bënin kontestimet juridike të trajtuara Vendimin e Kundërshtuar (Parashtrimet për Klasifikimin).⁴
4. Më 24 shkurt 2025, në zbatim të udhëzimeve të Trupit Gjykses,⁵ Administratorja iu përgjigj Kërkesës (Përgjigja).⁶

¹ KSC-BC-2023-10, F00680, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën për Rishikimin e Vendimit të Administratores për Honorarin e Ndihmës Juridike (F00518)*, 13 shkurt 2025, konfidencial dhe *ex parte*.

² KSC-BC-2023-10, F00682, Administratorja, *Parashtrim në bazë të F00680*, 18 shkurt 2025, konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2023-10, F00685, Mbrojtja e Shalës, *Kërkesë për Rishikimin e Vendimit mbi Kërkesën për Rishikimin e Vendimit të Administratores për Honorarin e Ndihmës Juridike (F00518)*, 19 shkurt 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00686, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrime në lidhje me F00518 dhe F00563*, 19 shkurt 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2023-10, CRSPD123, *Mesazh elektronik i Trupit Gjykses I drejtuar NJAGJ-së në lidhje me F00685 – Afatet e Dorëzimit të Parashtrimeve*, 20 shkurt 2025.

⁶ KSC-BC-2023-10, F00688, Administratorja, *Përgjigje e Administratores ndaj Kërkesës së Haxhi Shalës për Rishikim (F00685)*, 24 shkurt 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

5. Po atë ditë, mbrojtësi dorëzoi kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes (Kundërpërgjigja).⁷
6. Më 25 shkurt 2025, në zbatim të udhëzimeve të Trupit Gjykses,⁸ Administratorja iu përgjigj Parashtrimeve për Klasifikimin (Përgjigje ndaj Parashtrimeve për Klasifikimin).⁹
7. Më 27 shkurt 2025, mbrojtësi iu kundërpërgjigj Përgjigjes ndaj Parashtrimeve për Klasifikimin (Kundërpërgjigja ndaj Parashtrimeve për Klasifikimin).¹⁰

II. PARASHTRIMET

A. KËRKESË

8. mbrojtësi kërkon rishikimin e Vendimit të Kundërshtuar për shkak të një gabimi të qartë në arsyetim dhe për të shmangur padrejtësinë.¹¹ Pretendimi kryesor i mbrojtësit është që Trupi Gjykses dhe Administratorja kanë keqkuptuar argumentin e tij mbi përcaktimin e nivelit të kompleksitetit dhe lidhjen që ajo kërkon të bëjë midis qëndrimit të saj mbi nivelet relative të kompleksitetit dhe parashtrimit të saj se çështja aktuale duhet vlerësuar në nivelin 3 të kompleksitetit.¹² Më konkretisht, mbrojtësi parashtron se, në kundërshtim me konstatimet e Trupit Gjykses, përcaktimet e Administratores janë të pabaza, sepse ajo ka keqinterpretuar kategorizimet e ndryshme të kompleksitetit për çështje që kanë të bëjnë me dy lloje krimesh: krimet

⁷ KSC-BC-2023-10, F00689, Mbrojtja e Shalës, *Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Administratores ndaj Kërkesës së e Haxhi Shalës për Rishikim*, 24 shkurt 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2023-10, CRSPD124, *Mesazh elektronik i Trupit Gjykses I drejtuar NJAGJ-së mbi Udhëzimin drejtuar Administratores lidhur me Parashtrimin F00686*, 21 shkurt 2025.

⁹ KSC-BC-2023-10, F00690, Administratorja, *Përgjigje e Administratores ndaj Parashtrimeve të Haxhi Shalës lidhur me Parashtrimet F00518 dhe F00563 (F00686)*, 25 shkurt 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁰ KSC-BC-2023-10, F00692, Mbrojtja e Shalës, *Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Administratores ndaj Parashtrimeve të Haxhi Shalës lidhur me Parashtrimet F00518 dhe F00563 (F00686)*, 27 shkurt 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

¹¹ Kërkesa, para. 1, 11, 22.

¹² Kërkesa, para. 11-13, 17.

ndërkombëtare dhe ato brenda shtetit.¹³ mbrojtësi parashtron se nevoja për të kuptuar drejt kategorizimet e kompleksitetit të të dy llojeve të krimeve është e ngutshme, për të shmangur që disa faktorë sipas rregullën 16(3) të Rregullores së Ndihmës Juridike të vlerësohen në mënyrë të palejueshme në kuadër të përcaktimit të kompleksitetit të një krimi brenda shtetit.¹⁴ mbrojtësi përsërit kërkesën e saj që Trupi Gjykses të konstatojë se çështja duhet të klasifikohet në nivelin 3 të kompleksitetit, ose si alternativë, kërkon që Trupi Gjykses t'ia kalojë çështjen Administratores për të zbatuar “të kuptuarit e saktë” të niveleve të kompleksitetit.¹⁵

B. PËRGJIGJJA

9. Administratorja përgjigjet që Kërkesa duhet hedhur poshtë sepse mbrojtësi nuk vërteton ndonjë gabim të qartë në arsyetim apo padrejtësi që do të kërkonte marrjen e masës së jashtëzakonshme të rishikimit.¹⁶ Më konkretisht, Administratorja parashtron se: (i) nuk ka keqkuptim të argumentit të Mbrojtjes mbi nivelet relative të kompleksitetit; dhe (ii) argumenti i mbrojtësit u trajtua siç duhet në Vendimin e Administratores mbi Ndihmën Juridike (Vendimi për Ndihmën Juridike), sikurse u vu në dukje nga Trupi Gjykses.¹⁷ Administratorja argumenton më tej se, nuk është e mjaftueshme që thjesht të deklarojë se, në qoftë se të kuptuarit e mbrojtësit të niveleve të kompleksitetit zbatohet për faktet e çështjes aktuale do të kishte çuar në një vendim për nivel 3 të kompleksitetit, pa përdorur asnjë kriter të rregullës 16(3) të Rregullores së Ndihmës Juridike për të ilustruar pse çështja duhet vlerësuar në nivelin 3 të kompleksitetit, dhe se mbrojtësi arrin të demonstrojë gabim të *qartë* në arsyetim apo

¹³ Kërkesa, para. 12-13 dhe 19-21.

¹⁴ Kërkesa, para. 21.

¹⁵ Kërkesa, para. 22-23.

¹⁶ Përgjigja, para. 3 dhe 7.

¹⁷ Përgjigja, para. 5.

padrejtësi që do të përlijte rishikimin.¹⁸ Sipas Administratores, megjithëse vazhdon të shprehë mospajtim me rezultatin e Vendimit të Kundërshtuar, mbrojtësi prapëseprapë nuk i trajton kriteret e rregullës 16(3) të Rregullores së Ndihmës Juridike, që është edhe korniza ligjore konkrete ku bazohet Vendimi për Ndhmë Juridike.¹⁹

C. KUNDËRPËRGJIGJA

10. Mbrojtësi kundërpërgjigjet se: (i) Administratorja nuk trajton arsyet pse mbrojtësi parashtron që Administratorja nuk ka kuptuar argumentin e Mbrojtjes;²⁰ (ii) Administratorja fokusohet në mostrajtimin e kriterëve të rregullës 16(3) të Rregullores së Ndihmës Juridike nga mbrojtësi, kurse mbrojtësi parashtron se kriteret e mësipërme nuk zbatohen në vakum dhe se procesi i përcaktimit të nivelit të kompleksitetit është për nga vetë natyra e tij proces krahasues;²¹ dhe se (iii) moskuptimi si duhet i marrëdhënies midis niveleve të kompleksitetit për krimet brenda vendit ose ndërkombëtare çon në klasifikim të gabuar për sa u përket rasteve kur ka zbatim të ndryshëm të kriterëve për dy llojet e krimeve.²²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Trupi Gjykues mban parasysh nenin 21(2) dhe 40(4) dhe (6)(d) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe

¹⁸ Përgjigja, para. 4-6.

¹⁹ Përgjigja, para. 6, që i referohet KSC-BC-2023-10, F00518/A03, Administratorja, *Shtojca 3 e Kërkesës për Rishikimin e Vendimit të Administratores për Honorarin e Ndhmës Juridike*, 9 tetor 2024, konfidenciale dhe *ex parte*.

²⁰ Kundërpërgjigja, para. 6.

²¹ Kundërpërgjigja, para. 7-8.

²² Kundërpërgjigja, para. 8.

rregullat 79(1) dhe 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe Provave pra Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

IV. ANALIZA

A. STANDARDI LIGJOR PËR RISHIKIM

12. Fillimisht, Trupi Gjykses konstaton se rishikimi sipas rregullës 79(1) të Rregullores është masë e jashtëzakonshme që është objekt i kushteve të rrepta. E drejta e Trupit Gjykses për të rishikuar vendimet e tij të mëparshme duhet të ushtrohet me kursim dhe, rrjedhimisht, pala duhet të plotësojë një standard të lartë që mocioni për rishikim të miratohet.²³ Pala që kërkon rishikimin duhet të vërtetojë që Trupi Gjykses ka bërë gabim të qartë në arsyetim apo se rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë.²⁴

13. Trupi Gjykses vëren se, ndonëse pretendon që parashtrimet e tij kanë të bëjnë me të dy elementet e standardit, mbrojtësi nuk e trajton më tej standardin sipas rregullës 79(1) të Rregullores.²⁵ Trupi Gjykses do t'i shqyrtojë argumentet e mbrojtësit për të dy elementet e standardit në bazë të rregullës 79(1) të Rregullores.

²³ Shih gjithashtu, KSC-BC-2023-10, F00451, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Decision on Request for Reconsideration of F00444* (Vendim mbi Kërkesën për Rishikimin e Parashtrimit F00444) (Vendimi mbi Parashtrimin F00444), 27 gusht 2024, publik, para. 8; F00393, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Rishikimin e Vendimit F00325* (Vendimi mbi Parashtrimin F00325), 17 korrik 2024, publik, para. 13; F00183, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Rishikimin e Vendimit F00029*, 22 shkurt 2024, konfidencial, para. 30; KSC-BC-2020-04, F00587, Trupi Gjykses I, *Decision on the Defence's Request for Leave to Appeal and/or Reconsideration of F00538* (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikimin e Vendimit F00538), 13 korrik 2023, publik; F00830, Trupi Gjykses I, *Decision on the Defence request for leave to appeal and/or reconsideration of the "Decision on the Defence request for leave to reopen its case"* (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikimin e Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Rihapjen e Çështjes), 11 prill 2024, publik.

²⁴ Shih Vendimin mbi Parashtrimin F00444, para. 8.

²⁵ Kërkesa, para. 11, 22; Kundërpërgjigja, para. 9.

B. GABIM I QARTË NË ARSYETIM

14. Trupi Gjykues vëren se mbrojtësi pretendon një numër gabimesh në mënyrën se si Trupi Gjykues e ka kuptuar argumentin e mbrojtësit mbi përcaktimin e nivelit të kompleksitetit.²⁶ Së pari, sipas Trupit Gjykues, qëndrimi i mbrojtësit – në thelb – është që, duke pasur parasysh dallimet në shpërblim për çështjet që kanë të bëjnë me krime brenda vendit dhe ato ndërkombëtare, standardet e kompleksitetit përmbushet më shpejt në çështjet që kanë të bëjnë me krime brenda vendit, ose, siç pretendon mbrojtësi: “niveli i kompleksitetit që kërkohet për ta klasifikuar një krim të brendshëm si të nivelit 3, është shumë më i ulët”.²⁷ Për më tepër, Trupi Gjykues thekson se çështjet që kanë të bëjnë me krime të brendshme dhe ndërkombëtare nuk vlerësohen sipas të njëjtit shkallëzim kompleksiteti dhe ato nuk krahasohen me njëra-tjetrën për të përcaktuar nivelin e kompleksitetit. Në vend të kësaj, përcaktimi i nivelit të kompleksitetit bëhet në mënyrë të pavarur, bazuar në grupin e kritereve (të njëjta) sipas rregullës 16(3) të Rregullores së Ndihmës Juridike që janë të zbatueshme dhe duke marrë parasysh veçoritë e çdo rasti.²⁸ Për këtë arsye, Trupi Gjykues mendon se mbrojtësi kërkon të bëjë një deduksion të përgjithshëm – konkretisht se për shkak të ndryshimit në shpërblim midis rasteve të krimeve të brendshme dhe atyre ndërkombëtare, nivelet e kompleksitetit në rastet e krimeve të brendshme arrihen më shpejt – që nuk mishërohet në Rregulloren e Ndihmës Juridike. Ishte në këtë kontekst që Trupi Gjykues vlerësoi se argumenti i mbrojtësit ishte i pabazë, i pambështetur në Rregulloren e Ndihmës Juridike, dhe se ai ngatërron shpërblimin me kompleksitetin.²⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues mendon se mbrojtësi nuk artikulon asnjë gabim të qartë në arsyetim në lidhje me këtë aspekt.

²⁶ Kërkesa, para. 11-13 dhe 17; Kundërpërgjigjja, para. 6.

²⁷ Kërkesa, para. 10-11; Vendimi i Kundërshtuar, para. 13, 28.

²⁸ Vendimi për Ndihmën Juridike, para. 18.

²⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 28-29.

15. Së dyti, në lidhje me faktet e kësaj çështjeje, Trupi Gjykses rikujton se në marrjen e vendimit të saj, Administratorja shqyrtoi secilin kriter relevant sipas rregullës 16(3) të Rregullores së Ndihmës Juridike dhe dha arsye pse mendonte që kjo çështje, në fazën e gjykimit, duhet të vlerësohej në nivelin 2 të kompleksitetit.³⁰ Trupi Gjykses – pasi shqyrtoi arsyetimin e Administratores – konstatoi në vijim se me arritjen e përfundimit të mësipërm, Administratorja: (i) nuk keqpërdori diskrecionin e saj; (ii) nuk bëri gabim faktik apo ligjor, dhe (iii) nuk mori vendim qartësisht të paarsyeshëm.³¹ Mbrojtësi nuk i përgjigjet asnjë prej konstatimeve të mësipërme në Vendimin e Kundërshtuar dhe as vendimit të Administratores bazuar në kriteret e Rregullores së Ndihmës Juridike.

16. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk sheh të ketë ndonjë argument konkret që demonstroi gabim të qartë në arsyetimin e Vendimit të Kundërshtuar, që përllig rishikimin e tij.

C. SHMANGIA E PADREJTËSISË

17. Mbrojtësi pretendon se rishikimi është i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë, pa artikuluar asnjë lidhje midis Vendimit të Kundërshtuar dhe ndonjë padrejtësie faktike apo të mundshme. Në lidhje me pretendimin e mbrojtësit se vendimi i Administratores, që u shqyrtua nga Trupi Gjykses, është i pabazë, dhe kjo përbën arsye për rishikim për të shmangur padrejtësinë,³² Trupit Gjykses mendon se ky është i njëjti argument që mbrojtësi e paraqiti për të demonstruar një gabim në arsyetim. Pasi ka konstatuar se Kërkesa nuk demonstroi ndonjë gabim të qartë në

³⁰ KSC-BC-2023-10, F00518/A01, Administratorja, *Vendimi i Administratores për Përcaktimin e Nivelit të Kompleksitetit dhe Honorarin e Ndihmës Juridike për Fazën e Gjykimit*, 9 tetor 2024, konfidencial dhe *ex parte*. Pjesa III, para. 16-41.

³¹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 22-26, 27-30 dhe 31-32.

³² Kërkesa, para. 20-21; Kundërpërgjigja, para. 8.

arsyetim, Trupi Gjykues është i mendimit se nuk ka nevojë të ndërmerret ndonjë veprim korrigjues për shmangien e padrejtësisë.³³

D. PËRFUNDIM

18. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykues konstaton se nuk është demonstruar gabim në arsyetim apo nevojë për shmangien e padrejtësisë që, në rrethana të jashtëzakonshme, do të përlligjte rishikimin. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues e hedh poshtë Kërkesën.

V. KLASIFIKIMI I PARASHTRIMEVE TË PROTOKOLLUARA LIDHUR ME KËTË KONTESTIM JURIDIK

19. Trupi Gjykues konstaton se Administratorja dhe mbrojtësi nuk pajtohen për: (i) heqjen e shenjës *ex parte* në parashtrimet konfidenciale F00518 dhe F00563 pa redaktime të mëtejshme dhe për (ii) redaktimet që duhen bërë në versionet e redaktuara publike të këtyre parashtrimeve.³⁴ Trupi Gjykues vëren se informacioni në fjalë ka të bëjë me vendimin e Administratores mbi *nivelin e kompleksitetit* që i është caktuar kësaj çështjeje dhe honoraret e ndihmës juridike për ekipin e Mbrojtjes të z. Shala (niveli i kompleksitetit, honoraret e ndihmës juridike; së bashku, informacioni në fjalë).³⁵ Më konkretisht, Administratorja argumenton se redaktimet e propozuara vendosin balancën e duhur midis gjykimit publik dhe konfidencialitetit të vendimeve të Administratores për ndihmën juridike në një çështje të caktuar.³⁶ Sipas Mbrojtjes, informacioni në fjalë nuk ka të bëjë me veprimtarinë e Administratores, por në radhë

³³ *Shih, gjithashtu*, Vendimin mbi Parashtrimin F00325, para. 26.

³⁴ *Shih* Parashtrimet për Klasifikimin, para. 7, 9-12; Përgjigjja ndaj Parashtrimeve për Klasifikimin, para. 1-2; Kundërpërgjigjja ndaj Parashtrimeve për Klasifikimin, para. 2-4.

³⁵ *Shih* Parashtrimet për Klasifikimin, para. 7.

³⁶ Përgjigjja ndaj Parashtrimeve për Klasifikimin, para. 2.

të parë me Mbrojtjen. Rrjedhimisht, nëse mbrojtësi i specializuar pranon ta bëjë atë publik, nuk ka arsye të vlefshme pse informacioni në fjalë të mbetet konfidencial.³⁷

20. Trupi Gjykues rikujton parimin e gjykimit publik,³⁸ nga njëra anë, dhe detyrën e tij për të garantuar mbrojtjen e informacionit konfidencial, nga ana tjetër.³⁹ Trupi Gjykues mban parasysh faktin se mbrojtësi pranon t'i bëjë publike nivelin e kompleksitetit dhe honoraret e ndihmës juridike dhe, faktikisht, që të bëjë publike rezultatet e procesit të ndihmës juridike dhe kontestimet juridike përkatëse. Trupi Gjykues mendon gjithashtu se bërja publike e informacionit në fjalë nuk dëmton të drejtat dhe interesat e ndonjë prej individëve në këtë çështje (as të personave të tjerë të shpallur fajtorë dhe ekipeve të Mbrojtjes së tyre) dhe as nuk ndikon në kryerjen e detyrave të Administratores sipas nenit 34(7) të Ligjit dhe rregullës 23(6) të Rregullores; përkundrazi, kjo shton transparencën dhe siguron zbatimin e procesit ligjor të rregullt në sistemin e ndihmës juridike të Dhomave të Specializuara. Së fundi, Trupi Gjykues vëren se Administratorja nuk paraqit ndonjë argument konkret për të mbështetur nevojën për ta mbajtur informacionin në fjalë konfidencial, përveç që argumenton se informacioni në fjalë buron nga një vendim konfidencial i Administratores. Për këto arsye, Trupi Gjykues e gjykon të përshtatshme të urdhërojë, në bazë të rregullës 82(5) të Rregullores, riklasifikimin si publike dhe heqjen e shënimit *ex parte* nga parashtrimet e protokolluara F00518, F00541, F00563, F00680, F00682, F00685, F00686, F00688, F00689, F00690, dhe F00692 (aktualisht të klasifikuara si konfidenciale dhe *ex parte*).

³⁷ Kundërpërgjigjja ndaj Parashtrimeve për Klasifikimin, para. 4.

³⁸ *Shih* nenet 21(2) dhe 40(4) të Ligjit.

³⁹ Neni 40(6)(d) i Ligjit.

VI. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a. **RRËZON** Kërkesën; dhe
- b. **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë si publike dhe të heqë shënimet *ex parte* nga parashtrimet e protokolluara F00518, F00541, F00563, F00680, F00682, F00685, F00686, F00688, F00689, F00690, dhe F00692.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

E enjte, 6 mars 2025

Në Hagë, Holandë